



This project is funded
by the European Union



Empowered lives.
Resilient nations.

Programi i BE-së për Infrastrukturën Mbrojtëse ndaj Përmbytjeve





Programi i BE-së për Infrastrukturën Mbrojtëse ndaj Përmbytjeve



This project is funded
by the European Union



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Situata pas përmbytjeve

Më 31 Janar 2015, reshjet e shiut që vazhduan për rreth një javë, shkaktuan një rritje të papritur të nivelit të ujit në pjesën jug-perëndimore të vendit, duke shkaktuar përmbytje.

Përmbytjet ndikuan veçanërisht zonat përgjatë rrjedhës së Vjosës, Drinit, Osumit dhe Gjanicës, me një situatë më të rënduar në zonat e Vlorës dhe Fierit në jug-perëndim të Shqipërisë.

Duke marrë parasysh situatën, Qeveria Shqiptare kërkoi ndihmë emergjente nga partnerët ndërkombëtarë.

Deri në mes të Shkurtit, Misionet e Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Banka Botërore, në partneritet me pushtetin qendror dhe lokal, realizuan identifikimin e dëmeve dhe vlerësimin e nevojave pas përmbytjeve.

Raporti i Vlerësimit të Nevojave pas Përmbytjeve u prezantua në Prill të 2015. Raporti identifikonte dhe vlerësonte nevojat për sektoret më kyç të prekur nga përmbytjet. Ai gjithashtu identifikonte një strategji rikuperimi paraprak dhe një plan prioritetesh që përfshinte nevojat afat-shkurtra, afat-mesme dhe ato afat-gjata.

Cilat ishin gjetjet e raportit?

Një total prej 9 rajonesh dhe 53 bashkish rezultuan të prekur nga përmbytjet.

Popullsia totale e prekur nga përmbytjet në këto zona rezulton në 397,316 njerëz.

Rreth 12,225 ha tokë e punueshme dhe e mbjellë u fundos, duke dëmtuar të korrura në faza të ndryshme zhvillimi.

Afërsisht 15,000 vendbanime fermersh u ndikuan dhe 9,992.6 ha prodhime bujqësore u dëmtuan.

31 JANAR 2015

RAPORTI I VLERËSIMIT
TË NEVOJAVE
PAS PËRMBYTJEVE

PËRMBYTJET


12.225

HA TOKË



397.316

NJERËZ



15.000

VENDBANIME



Raporti i vlerësoi humbjet, dëmtimet dhe nevojat e menjëhershme në një shumë prej rreth 110 milionë EUR. Raporti vuri gjithashtu në dukje se situata e krijuar nuk ishte thjesht një pasojë e reshjeve të vazhdueshme të shiut, por kryesisht pasojë e:

- Degradimit mjedisor,
- Mungesës së menaxhimit të duhur të ujëmbledhësave
- Mungesës së vlerësimit të rrezikut në përdorimin e tokës dhe vendbanimeve dhe
- Dobësive sociale në rajonet e prekura.

Mbi bazën e gjetjeve të këtij raporti Qeveria Shqiptare, në kuadër të nevojave/ndërrhyrjeve afat-shkurtra, përcaktoi si më emergjente ndërhyrjen për rehabilitimin apo ndërtimin e plotë të 16 veprave infrastrukturore për mbrojtjen nga përmbytjet, të cilat ishin dëmtuar pjesërisht apo shkatërruar plotësisht gjatë përmbytjeve të fundit në zonat: Fier, Vlorë, Gjirokastër, Berat, Korçë, duke marrë përsipër, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, realizimin e projekteve teknike për këto 16 vepra.

Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri siguroi financimin prej 6 milionë Euro për realizimin e këtyre veprave. UNDP mori përsipër realizimin konkret të këtyre veprave, duke kontribuar me 300 000 Euro, nëpërmjet projektit: “Mbrojtja Infrastrukturore ndaj Përmbytjeve”.

Çfarë synon projekti?

Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Bashkimi Europian, do të realizohen këto ndërhyrje:

1. Rehabilitimi/ndërtimi i 16 objekteve të infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet, të dëmtuara pjesërisht apo plotësisht në zonat: Vlorë, Fier, Gjirokastër, Berat dhe Korçë, që konsistojnë kryesisht në 16 kilometra argjinatura lumore, kanale për ujitje dhe tharje, si dhe rehabilitimin e stacionit të pompave në hidrovorin e Akernisë.
2. Në kuadër të këtij projekti, do të zbatohet një fushatë ndërgjegjësimi mbi ndikimet sociale që kanë fatkeqësitë natyrore mbi komunitetet dhe veçanërisht si ndikojnë përmbytjet tek grupet në nevojë.
3. Ndërgjegjësimi i aktorëve vendorë, institucioneve përkatëse qendrore dhe vendore dhe komuniteteve në zonën e basenit të lumit Vjosë, për ndikimet dhe rreziqet që kanë të bëjnë me ndryshimin e klimës dhe nevojën për marrjen e masave përshtatëse.

Projekti i financuar nga Delegacioni i Bashkimit Europian dhe i zbatuar nga PNUD në partneritet me Qeverinë Shqiptare do të rehabilitojë 16 vepra infrastrukturore mbrojtëse nga përmbytjet, të cilat janë dëmtuar pjesërisht apo plotësisht në këto zona: Vlorë, Fier, Gjirokastër, Berat dhe Korçë.

Zonat Armen-Bishti i Malit dhe Selenicë-Armen

Infrastruktura mbrojtëse nga përmbytjet në përroin e Otimës
në zonat Armen-Bishti i Malit dhe Selenicë-Armen, rajoni Vlorë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



78 852 663



Zonat Hore dhe Kallarat-Vranisht

Mbrojtja nga përmytjet e lumit Shushicë dhe gërryerjeve të bregut në zonën e Hore dhe Kallarat-Vranisht, rajoni Himarë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



27 965 700



Zonat Ceprat-Risili dhe Ceprat-Dheu i Bardhë

Mbrojtja nga përmbytjet e lumit Shushicë dhe gërryerjeve të bregut në zonat Ceprat-Risili dhe Ceprat-Dheu i Bardhë, rajoni Vlorë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



74 572 825



Zonat Bishan, Mifol-Fitore dhe Novoselë

Mbrojtja nga përmbytjet e Lumit Vjosë në krahun e majtë në zonën Bishan dhe riparimi i krahut të majtë të argjinaturës së kanalit U1, në zonën Mifol-Fitore, zona Novoselë, rajoni Vlorë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



123 917 517



Zona Çervë

Mbrojtja nga lumi Vjosë e krahut të majtë të argjinaturës së Kanalit KU Martinez në zonën Çervë, rajoni Fier.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



11 571 480



Zonat Mashkullorë, Palokastër dhe Shtëpez (vijon)

Mbrojtja nga përmbytjet e lumit Drino dhe të gërryerjeve të bregut në zonën Mashkullorë, rajoni Gjirokastrë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



43 848 063



Zonat Mashkullorë, Palokastër dhe Shtëpez

Mbrojtja nga përmbytjet e lumit Drino dhe të gërryerjeve të bregut në zonën Palokastër, rajoni Gjirokastrë.

Mbrojtja nga përmbytjet e lumit Drino dhe të gërryerjeve të bregut në fshatin Shtëpez, rajoni Gjirokastrë.



Zonat Gerhot, kanalit ujitës V-3-12 dhe Ura e Valaresë (vijon)

Mbrojtja nga përmbytjet e lumit Drino dhe gërryerjve të bregut në zonën Gerhot, rajoni Gjirokastrë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



51 954 595.6



Zonat Gerhot, kanalit ujitës V-3-12 dhe Ura e Valaresë

Riparimi i dëmtimeve të argjinaturës së kanalit ujitës V-3-12, rajoni Gjirokastrë.

Mbrojtja nga përmbytjet e lumit Drino të Tregut Ushqimor dhe gërryerjeve të bregut në një zonë të urës së Valaresë, rajoni Gjirokastrë.



Zona Vashtemisë

Punime mbrojtëse ndërmjet gjatësive 400 – 680 km në kaskadën e lumit Dunavec në zonën e Vashtemisë, rajoni Korçë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



130 154 694



Laguna e Nartës – Akerni

Riparimi i argjinaturës së Selevcit në zonën Laguna e Nartës – Akerni, rajoni Vlorë.

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



56 827 466



Zona e Suhes

Mbrojtja nga përmytjet e lumit Drino dhe nga gërryerjet e bregut në zonën e Suhes, rajoni Gjirokastrër

VLERA E PROJEKTIT (LEKË)



20 776 538





This project is funded
by the European Union



*Empowered lives.
Resilient nations.*